

Fletë informacioni për rregullat e izolimit në Saksoni

Përditësuar në: nëntor 2021

Çfarë duhet bërë¹ nëse dyshohet se jeni infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2, nëse rezultati i testit është pozitiv dhe në rast kontakti të ngushtë me një të infektuar?

1. NËSE DYSHOHET SE JENI TË INFEKTUAR

Testi i shpejtë që keni bërë (pa mbikëqyrje) ka dalë pozitiv ose keni simptoma të COVID-it dhe keni bërë një test PCR?

- Ju duhet të rrini në shtëpi (d.m.th. të izoloheni).
- Ju lejohet të dilni nga shtëpia ose banesa juaj, vetëm nëse keni nevojë për ndihmë mjekësore (informoni zyrën e mjekut se dyshoni që jeni të infektuar).
- Nëse jetoni me njerëz të tjerë, mundohuni t'u shmangeni atyre sa më shumë të jetë e mundur.
- Nuk ju lejohet të prisni vizita nga njerëz që nuk jetojnë me ju.
- Lutemi informoni punëdhënësin tuaj, se dyshoni që mund të jeni të infektuar me koronavirus.

Nëse testi PCR është negativ, izolimi mbaron menjëherë. Ruajeni rezultatin negativ të testit. Nëse testi PCR është pozitiv, ju duhet të vazhdoni të qëndroni të izoluar (shih pjesën 2.: Rezultat pozitiv i testit).

2. NËSE REZULTATI I TESTIT ËSHTË POZITIV:

- Ju duhet të rrini në shtëpi (d.m.th. të izoloheni) për të paktën 14 ditë. Nëse vazhdoni të keni simptoma, koha do të zgjatet.
- Ju lejohet të dilni, vetëm nëse ju duhet të shkoni te mjeku.
- Nëse jetoni me njerëz të tjerë dhe keni pasur kontakt të ngushtë me ta në dy ditët e fundit, duhet t'u tregoni menjëherë se jeni pozitiv dhe se edhe ata duhet të rrinë në shtëpi (shih pjesën: 3. Personat e kontaktit).
- Tregojuni edhe të gjithë të tjerëve (përfshirë edhe ata që janë vaksinuar dhe shëruar), me të cilët keni pasur kontakt dy ditë para testit ose para shfaqjes së simptomave. Të gjithë duhet të bëjnë test në ditën e 4-t ose të 5-të pas kontaktit me ju. Ai bëhet në një qendër testimi.
- Rrijuni larg njerëzve të shtëpisë që të mos i infektoni.
- Njoftoni punëdhënësin ose shkollën tuaj.
- Aktivizoni aplikacionin Corona-Warn-App dhe shëno aty rezultatin e testit.
- Nëse jeni plotësisht të vaksinuar dhe nuk keni simptoma, në ditën e 5-të mund të bëni një test PCR ose në ditën e 7-të një test antigen në një qendër testimi. Nëse testi është negativ, nuk duhet të izoloheni më. Ruajeni rezultatin e testit, në rast se Zyra e Shëndetit Publik [Gesundheitsamt] do që ta shohë.

3. NË RAST KONTAKTI TË NGUSHTË ME NJË PERSON TË TESTUAR POZITIV (person kontakti):

- Nëse jetoni me dikë që është testuar pozitiv, atëherë ju quheni si person kontakti (anëtar i familjes). Ju duhet të qëndroni në shtëpi (të izoloheni), nëse nuk jeni plotësisht të vaksinuar ose nuk e keni kaluar virusin.
- Izolimi juaj fillon në ditën e parë pas kontaktit dhe përfundon pas 10 ditësh, nëse ndërkohë ju vetë nuk jeni testuar pozitiv ose nuk keni shfaqur simptoma.
- Njoftoni punëdhënësin ose shkollën tuaj. Si vërtetim mund të përdorni informacionin që Zyra e Shëndetit Publik [Gesundheitsamt] ia ka nisur personit të testuar pozitiv që jeton bashkë me ju.
- Ju lejohet të dilni, vetëm nëse ju duhet të shkoni te mjeku ose të bëni testin.
- Mund të testoheni në ditën e 7-të me një test PCR ose test të shpejtë antigen, nëse doni ta përfundoni më përpara izolimin. Këta bëhen në një qendër testimi. Ruajeni rezultatin e testit, në rast se Zyra e Shëndetit Publik [Gesundheitsamt] do që ta shohë.
- Të gjithë personat që kanë pasur kontakt me një person që është testuar pozitiv (edhe nëse janë paralajmëruar nëpërmjet aplikacionit Corona-Warn-App) dhe nuk janë të izoluar, duhet të testohen në ditën 4-t ose 5-të pas kontaktit dhe ndërkohë të takohen me sa më pak njerëz të jetë e mundshme.

Këtu mund të gjeni informacione të mëtejshme: Faqja e internetit e qarkut të Landit ose e qytetit tuaj dhe <http://www.coronavirus.sachsen.de>.

Ndihma juaj tani është shumë e rëndësishme që të mund ta ndalojmë së bashku pandeminë.

¹ në përputhje me dekretin e përgjithshëm për izolimin e personave të afërt të kontaktit, të personave që dyshohen dhe të atyre që janë testuar pozitiv ndaj koronavirusit në qarkun tuaj të Landit ose të qyteteve të pavarura në Shtetin e Lirë të Saksonisë - shihni portalin aty portalin e internetit.